



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 79 dt.30.04.1996

Këshilli Bashkiak i Qytetit Tiranë, i mbledhur sot me dt.30.04.1996, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Zyra Administratës për nevojat që ka Bashkia Tiranë për rikonstruksion zyrash, blerje automjete, kompjutera, tavolina, karrike dhe rafte, mbështetur në V.K.M. Nr.673, dt.29.11.1995 “Mbi përdorimin e të ardhurave nga Pushteti Lokal”, pika.2/c për destinacionin e përdorimit të të ardhurave lokale,

VENDOSI

1. Të miratojë fondin vjetor prej 10 milion lekë për rikonstruksion zyrash, blerje automjete dhe pajisje zyrash i cili do çelet nga të Ardhurat e Bashkisë.
2. Zyra Administratës dhe Drejtoria Administrimit Financiar do të ndjekin zbatimin e këtij vendimi nëpërmjet kontrollit në përdorimin e këtyre fondeve pas llogaritje dhe çeljes së tyre.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA